

VENDIM
Nr. 9 datë 6.2.2014

**MBI NJË SHITESË NË RREGULLOREN “MBI PROCEDURAT E EMËRIMIT TË
ADMINISTRATORIT DHE KOMPETENCAT E TIJ”, NË ZBATIM TË NENIT 18, PIKA 4/C TË
LIGJIT NR. 9072, DATË 22.5.2003 “PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “l” dhe 18, pika 4, germa “c” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.2.2014, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, lidhur me një shtesë në rregulloren “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, në zbatim të nenit 18, pika 4, germa “c” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë vendimin nr. 150, datë 30.12.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Mbi prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes, që nuk mbulohet nga prokurimi vjetor”.

2. Të shtojë në nenin 12, pika 4 të rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, në zbatim të nenit 18, pika 4 germa “c” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, paragrafin me përmbajtjen si më poshtë:

““CEZ Shpërndarje” sh.a. në administrim të përkohshëm, për nevoja të mbulimit të plotë të humbjeve në sistemin e shpërndarjes, të realizojë blerjet e energjisë elektrike mbi baza mujore për sasinë e energjisë elektrike që nuk mbulohet nga prokurimi vjetor. Për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes mbi baza mujore, administratori zbaton vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 30, datë 23.3.2011 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga “KESH” sh.a.”.”

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë “OSSH” sh.a. për vendimarrjen e ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti